



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

ARKIVI SHTETËROR I SISTEMIT GJYQËSOR

Procedura e aplikimit për një dokument arkivor gjyqësor nga një subjekt kërkues jo-shtetëror [individ dhe person fizik/juridik]

Në mbështetje të VKM Nr. 252, datë 29.04.2022, “Për procedurat e ofrimit të Shërbimeve *ON-LINE* nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, **shërbimi i dërgimit dhe/apo studimit të çfarëdo dokumenti arkivor gjyqësor kryhet vetëm nëpërmjet platformës e-albania.**

ASNJË KËRKESË NUK PRANOHET ME POSTË APO PERSONALISHT PRANË NESH.

Hapni linkun www.e-albania.al, përdorni butoni Hyr, më pas zgjidhni opsionin si qytetar, vendosni numrin personal të ID dhe fjalëkalimin për të aksesuar profilin tuaj.

Klikoni tek Shërbime me titullin: “Aplikim online për dokumente arkivore gjyqësore nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor”.

➤ **Klikoni opsionin Përdor**

Zgjidhni llojin e aplikimit: Zgjidhni opsionin - Njohje pronësie/trashëgimie; Birësim, Njohje atësie; Penale;

Lidhja e kërkuesit me paditësin: Zgjidhni opsionin - Vetë personi; I ati/e ëma; Gjyshe; Katragjyshe; Trashëgimtar tjetër;

Të dhënat e dosjes gjyqësore - Plotësoni vendet bosh:

Numri i vendimit..... Data, muaji, viti Gjykata.....

➤ **Klikoni opsionin Dërgo.**

Ngarko ID - e detyrueshme për çdo kërkesë.

Ngarko prokurë - e detyrueshme në rast se jeni përfaqësues ligjor.

Ngarko certifikatë trungu familjar - e detyrueshme në rast se jeni trashëgimtar.

Ngarko kontratë shitje-blerje - e detyrueshme në rast të fitimit të pronësisë me blerje.

Ngarko vërtetim nga gjykata - e detyrueshme në rast se jeni palë në një proces gjyqësor.

KUJDES: Nëse nuk keni lidhje të qartë me dokumentin gjyqësor që kërkoni, **DUHET** të bashkëlidhni dokumentin që vërteton lidhjen ligjore.

Pas marrjes së kërkesës online, pas verifikimit përkatës për dokumentin dhe lidhjen ligjore, nëse dokumenti arkivor gjyqësor i kërkuar ndodhet në ASHSGJ në aplikimin tuaj në platformën e-albania ngarkohet fatura e pagesës.

Kërkuesi shkarkon faturën dhe kryen pagesën në çdo bankë. **Çdo akt nga dosja gjyqësore kushton 200 lekë.**

Pasi kërkuesi ngarkon konfirmimin bankar për kryerjen e pagesës në aplikimin e kryer, ASHSGJ i vë në dispozicion kërkuesit dokumentin arkivor gjyqësor të kërkuar në format digjital me nënshkrim elektronik.

NËSE nga verifikimi i kryer: a. dokumenti arkivor gjyqësor i kërkuar **NUK** rezulton në fondin tonë; b. dokumenti që vërteton lidhjen ligjore me të **NUK** bashkëlidhet në aplikim; ose c. konfirmimi bankar për kryerjen e pagesës **NUK** bashkëlidhet në aplikim, **ASHSGJ REFUZON OFRIMIN E SHËRBIMIT** duke saktësuar në shkresën e ngarkuar në aplikimin tuaj arsyen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune.

DREJTOR

Dr. Alfred ÇAUSHI